

FTESE PËR OFERTË

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruksion,
Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: 7 Prill 2026

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin “*Mjedisi në sytë e të rinjve (N'SY)*” mbështetur nga Bashkia e Tiranës. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të realizojë procedurën e prokurimit e thjeshtë për “**Ekspert Regjisor për Trajnimin e të Rinjve dhe Prodhimin e Filmit të Shkurtër**”.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 7 Prill 2026, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në adresën Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për ekspertizë Ekspert Regjisor për Trajnimin e të Rinjve dhe Prodhimin e Filmit të Shkurtër, sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i ekspertizës	Ditë Pune	Çmimi/njësi Lekë
1.	Ekspert Regjisor për trajnimin e të rinjve dhe për prodhimin e një filmi me metrazh të shkurtër	12	
	Totali		

Ekspteri regjisor do të angazhohet në kuadër të projektit për të trajnuar dhe mentoruar të rinjtë në procesin e realizimit të materialeve audiovizive me tematikë mjedisore, në veçanti për temat që lidhen me ndryshimet klimatike dhe ekonominë e qëndrueshme. Aktivitetet e trajnimit dhe mentorimit do të përfshijnë rreth 20 të rinj të moshës 18-35 vjeç, të cilët do të organizohen në grupe pune për zhvillimin e ideve dhe prodhimin e filmave të shkurtër sensibilizues.

Ekspteri do të angazhohet për 12 ditë pune përgjatë periudhës së zbatimit të projektit, duke përfshirë:

A. Organizimin e një **trainimi 2 ditor** ku të përfshihet:

- përgatitja e materialeve të trajnimit
- zhvillimi i sesioneve të trajnimit praktik dhe udhëzimi i pjesëmarrësve në teknikat e filmimit

B. Ekspteri do të asistojë grupet e të rinjve në **4 vizita studimore në Tiranë** për:

- mentorimin gjatë filmimeve në terren, plane të ndryshme

C. Ekspteri do të **asistojë grupet në përpunimin dhe montazhin e materialeve filmike**, duke përfshirë:

- seleksionimin e materialeve
- ndërtimin e strukturës narrative
- përdorimin e muzikës dhe efekteve vizuale
- integrimin e titrave dhe elementeve grafike.

Produktet audiovizive që do të realizohen përfshijnë:

- **4 video me tematika mjedisore me kohëzgjatje 7-10 minuta**
- **një video të shkurtër promocionale (reel) deri në 60 sekonda për përdorim në rrjete sociale.**

Materialet finale duhet të dorëzohen në format HD (Full HD ose më të lartë) dhe në formë digjitale (USB / CD / link transferimi).

Me subjektin ose ekspertin fitues do të lidhet një kontratë shërbimi, sipas kushteve të projektit dhe legjislacionit në fuqi.

Kushte të përgjithshme:

1. Të ketë aftësi profesionale në filmim, regji dhe montazh video.
2. Të jetë në gjendje të ofrojë ide kreative dhe qasje vizuale inovative për prodhimin e videove sensibilizuese.
3. Të ketë aftësi për zhvillimin e skenarëve të strukturuar dhe narrativave vizuale efektive.
4. Të ketë eksperiencë në realizimin e materialeve audiovizive me tematikë mjedisore, sociale ose kulturore në Shqipëri.
5. Preferohet që eksperti të ketë eksperiencë në trajnimin ose mentorimin e të rinjve në videomaking dhe storytelling vizual.
6. Eksperti duhet të përfshijë në ofertën e tij të gjitha kostot teknike, logjistike (transport, dieta, pajisje të nevojshme, etj.) dhe financiare.

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 7 Prill 2026, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në Adresën Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruktion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

Pagesa e subjektit/personit fizik do të kryhet me transfertë bankare pas përfundimit të shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse, ose si subjekt i tatimit mbi të ardhurat (15%) sipas legjislacionit shqiptar.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Krahës ofertës financiare të plotësuar sipas tabelës në ftesë (në Lekë), duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) CV ku të tregohen eksperiencat e mëparshme (të vërtetuara me faturë ose kontrata);
- 2) Ekstraktin e QKB në rastin kur është subjekt, ose ID në rastin e personit fizik;
- 3) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

AUTORITETIT KONTRAKTOR
Milieukontakt Shqipëri